

Qendra për Hulumtim të Migracionit dhe Ndhmë Refugjatëve (QHMR) së bashku me Friedrich Ebert Stiftung (FES) kanë organizuar me 14.11/2003 Konferencë me titull pune:

“Kthimi dhe riintegrimi i personave të zhvendosur dhe refugjatë (minoritarë) në Kosovë – Rezultate dhe Probleme”

Punimet e konferencës ishin fokusuar për të kontribuar në aktualizimin dhe inkurajimin në veçanti të minoritarëve për kthim të qëndrueshëm e substancial në vendlindje. Pjesëmarrësit e konferencës dhanë një kontribut të theksuar dhe ide për krijimin e një ambienti social dhe politik i cili do të mundësonte që të gjithë personat e zhvendosur dhe refugjatë të luftës të kenë shansë të barabartë për një kthim dinjitoz në vendin e tyre të origjinës.



Në veçanti u diskutuan në mënyrë kritike katër grupe faktorësh që ushtrojnë ndikim në kthimin dhe riintegrimin substancial të personave të zhvendosur:

- **Siguria dhe liria e lëvizjes**
- **Qasja në shërbime publike, sociale, arsimore, kulturore në gjuhën amtare**
- **Qasja në strehim – Riposedimi i pronave dhe shtëpive**
- **Krijimi i mundësive dhe shanceve të barabarta për punësim**

Pjesëmarrës në konferencë ishin (përveq organizatorit – Prof. Dr. Rifat Blaku – Besa Shema):

- përfaqësues nga UNMIK-u (zyra për kthime dhe komunitete),
- të OSBE-së, UNHCR-së, KFOR-i (gjenerali britanez),
- zyra e kryeministrit (Bekim Çollaku),
- përfaqësuesi i kryeparlamentarit (Mr. Ramush Tahiri),
- zyra e Ombduspersonit (i komunitetit boshnjak),
- zyra italiane,
- zyra zvicerane (Andreas Wormser),
- përfaqësuesi i TMK-së (Skender Muçolli),
- përfaqësuesi i hashkalive (Bajrush Berisha),
- si dhe përfaqësues të mediave elektronike dhe korrespondent të jashtëm.

Konferenca ka zgjuar një interesim të madh në opinion dhe është regjistruar në të gjitha mjetet e informimit publik në Kosovë.

Të gjithë pjesëmarrësit që kanë diskutuar në këtë konferencë kanë bashkangjitur edhe materialet e shkruara!

Publikimi i materialeve të kësaj konference është me interes të veçantë për senzibilizimin dhe inkurajimin e mëtejme të procesit të kthimit në veçanti të minoritarëve në Kosovë.

Bekim Çollaku

"Kthimi dhe Riintegrimi i personave të zhvendosur dhe refugjatë në Kosovë - Rezultate dhe probleme"

- Përshëndetje në emër të Kryerninistrit dhe të Qeverisë së Kosovës për organizatorët e kësaj konfence dhe gjithë pjesëmarrësit në takim.
- Shprehja e keqardhjes për incidentin që ndodhi dhe në fshatin Mushtisht të kornunës së Therandës (ish-Suharekë).

Rëndësia e Procesit të Kthimit

Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes IPVQ-të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në çdo fazë të procesit të kthimit dhe të integritit të bashkësive pakicë.

Ardhmëria e Kosovës varet në masë të konsiderueshme nga aftësia e popullit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, zyrtarëve të qeverive lokale për t'u angazhuar në procesin e kthimit të të zhvendosurve, promovimin e dialogut ndëretnik, në nxitjen e tolerancës dhe pranimin e të drejtës së tyre për t'u kthyer, si dhe në inkurajimin e pjesëmarrjes së tyre në strukturat e përkohshme të qeverisë.

Sipas standardeve ndërkombëtare, refugjatët dhe personat e zhvendosur kanë të drejtën fundamentale humane për t'u kthyer në shtëpitë e tyre, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, në mënyrë spontane, të organizuar apo të ndihmuar. Kjo është në pajtim me Rezolutën 1244 të OKB-së (1999), Kornizën Kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

E drejta mbi pronën është një nga të drejtat fundamentale të njeriut dhe në fakt, i tërë koncepti teorik i të drejtave të njeriut i cili është zhvilluar në civilizimin perëndimor është bërë nga nevoja për mbrojtjen e pronës private.



Prandaj, asnjë njeri i ndershëm nuk mund të jetë në parim kundër kthimit të personave të zhvendosur në pronën e tyre.

Bashkëqytetarët tanë afrimojnë vlerat e civilizimit modern botëror, Qeveria e Kosovës ka objektiv parësor integrimin e Kosovës si entitet i veçantë në strukturat Euro-Atlantike, prandaj do të mbështes fuqimisht që kjo e drejtë fundamentale të respektohet dhe mbrohet me ligj.

Nisur nga pikëpamja morale dhe ligjore, të mohosh të drejtën e personave të zhvendosur për t'u kthyer në pronën dhe shtëpitë e tyre, nënkupton favorizimin e vjedhjes. Nga pikëpamja politike, ata që kundërshtojnë kthimin e personave të zhvendosur të cilës do përkatësie qofshin ata, për në mënyrë të veçantë ata që janë kundër kthimit të Serbëve të zhvendosur, i kontribuojnë vetëm Beogradit dhe planit për cënimin e Kosovës.

Prandaj, nuk duhet të ketë asnjë dilemë rreth çështjes se a duhet apo nuk duhet të ndodhë kthimi.

Qeveria e Kosovës synon ndërtimin e shoqërisë bazuar në vlerat dhe në përputhshmëri me normat morale dhe juridike të shoqërive perëndimore. Dhe në perendim, e drejta mbi pronën private është e padiskutueshme. Qeveria e Kosovës është shumë e vetëdijëshme për të gjitha këto, andaj i kushton përkujdesje të vazhdueshme çështjes së kthimit dhe mbështet plotësisht procesin e kthimit të pronës private pronarëve ligjorë, pavarësisht nga përkatësia etnike; dhe gjithashtu mbështet fuqimisht krijimin e tolerancës, pajtimit, bashkëjetesës me qëllim që pronarët të gëzojnë pronat e tyre në paqe.

Fundamentale për t'i gëzuar plotësisht këto të drejta dhe shkallën deri në të cilën komunitetet e pakicave mund të integrohen dhe të marrin pjesë në shoqëri është qarkullimi i tyre i lirë. UNMIK-u dhe KFOR-i do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar lirinë e qarkullimit për të gjithë të kthyerit dhe komunitetet në Kosovë.

Qeveria është e zotuar fuqimisht që të punojë me qytetarët e Kosovës me qëllim që të krijohet një ambient i përshtatshëm shoqëror dhe politik për të kthyerit.

Dështimi eventual i institucioneve të Kosovës dhe i qytetarëve të saj për të siguruar dhe avancuar të drejtat e komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë përpos që do të rrisë rrezikun e legjitimitetit të enklavave serbe dhe mbase do inkurajon coptimin eventual të territorit të Kosovës, gjë; që për Qeverinë e Kosovës është tërësisht e papamueshme. poashtu do të ketë edhe pasoja të tjera negative në planin afatgjatë për Kosovën: seriozishtë do të vëjë në pikëpyetje mundësinë e integritetit të Kosovës në Unionin Europian dhe në strukturat tjera Veri-Atlantike.

Për shkak të gjitha këtyre arsyeve, shqiptarët e Kosovës që përbëjnë shumicën e popullsisë së Kosovës bashkë me institucionet e vendit duhet që ta perkrasin fuqimishtë kthimin dhe integrimin e të gjithë personave të zhvendosur.

Kthimi i personave të zhvendosur nuk e rrezikon pavarsinë e Kosovës, përkundrazi është kusht për integritetin territorial dhe realizimin e synimeve tjera të Kosovës për integrim. Komuniteti ndërkombëtarë ka vënë si kushte përbushjen e tetë standardeve përpara se të vendoset për statusin përfundimtar të Kosovës. Këto standarde nuk janë synim vetëm i komunitetit ndërkombëtar por janë objektiva të Qeverisë dhe qytetarëve tanë sepse të gjitha lidhen në menyrë të drejtëpërdrejtë me përmirësimin e jetës dhe ngritjen e mirëqenjes në vend. Boshti kryesor i këtyre standardeve që do ti hapë perspektivë Kosovës është respektimi i të drejtave të komuniteteve tjera pakicë që jetojnë në Kosovë.

Qeveria e Kosovës është e bindur se në këtë drejtim ka përkrahjen e qytetarëve të vendit dhe se bashkarishtë do punojnë që ta bëjnë Kosovën vend demokratik, ku do të respektohen të drejtat njerëzore në mënyrë të barabartë për të gjithë; vend ku të gjitha komunitetet do të jenë në gjendje të levizin lirshëm pa pasur nevojë për masat e sigurisë; vend ku të gjitha komunitetet do ta perdorin lirshëm gjuhën e tyre dhe do të gëzojnë mundësi të barabartë punësimi dhe shfrytëzim të barabartë të shërbimeve publike dhe sociale.

Eksperienca jo e largët e shqiptarëve të Kosovës ishte ajo e dhunës dhe e spastrimit etnik, tani komunitetet jo-shqiptare kanë probleme që e vështirësojnë kthimin dhe jetën e tyre në Kosovë. Kjo duhet të marrë fund.

Heinrich Hertz ka thënë "ajo ç'farë rrjedh nga eksperiencia mund të anulohet përsëri nga eksperiencia". Prandaj, eksperiencia e hidhur jo e largët e shqiptarëve, eksperiencia jo e mirë e komuniteteve jo shqiptare e tanishme, do të anulohet me një eksperiencë të re të përbashkët për të gjithë qytetarët e Kosovës. Kjo do të jetë eksperiencë e paqes, dhe e lirisë për të gjithë.

Duke iu dëshiruar punë të mbarë konferencës, pranoni edhe një herë konsideratën e lartë të Kryeministrit për të gjithë pjesëmarrësit.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj.

Bekim Çollaku
Këshilltar Poltik i Kryeministrit të Kosovës

Prof. Dr Rifat Blaku

MUNDËSITË E IMPLEMENTIMIT TË STANDARDEVE PËR KOSOVËN

TË GJITHA PLANET PËR KTHIMIN E SERBËVE NË KOSOVË DHE DISA PREJ ARSYEVE PËR DËSHTIMIN E TYRE

Duke u nisur nga fakti se çështja e kthimit dhe integritetit të personave të zhvendosur minoritarë e në veqanti atyre Serb është njëra nga sfidat më të mëdha, më të rënda e më delikate në kuadër të permbushjes së (detyrave)



të planit të implementimit të standardeve për Kosovën - agjendë kjo nga më kryesoret e politikës ndërkombëtare në Kosovë edhe para ngjarjeve të mesmarsit, bile edhe në tërë periudhën e pasluftës, e me qëllim të nxjerrjes së një pasqyre sa më të qartë e gjithëanëshme në lidhje me punën dhe përpjekjet ndërkombëtare, vendore (por edhe të Beogradit zyretarë), për të realizuar këtë objektivanaliza jonë, këtu evidenton në mënyre kronologjike, retrospektive, shumicën e planeve, politikave, praktikave dhe aktiviteteve për këtë destinim. Që nga 4 maji i vitit 2000, me qëllim të inkurajimit e stimulimit të kthimit të minoritarëve, kur në manastirin e Graçanices ishte krijuar komiteti i përbashkët për kthimin e serbve (JCR) e deri më 17 mars ishin shpallur me dhjetra plane, projekte e strategji të kthimit që mbanin emërtime nga më të ndryshmit, bile edhe të koduara. Kjo shihet nga tabela në vijim:

TË GJITHA PLANET (ANGAZHIMET) PËR KTHIMIN E MINORITARËVE (SERBË) NË KOSOVË

1. Komitete	- Komiteti i përbashkët për kthimin e serbëve (JCR) me 04.05.2000 në Graçanicë. - Komiteti për çështje të kthimeve dhe azilit në paktin e stabilitetit.
2. Korniza	Korniza për kthimin e serbëve 6 janar, 2001.
3. Projekte	Projekt operacioni “Trojan 1” dhe “Trojan 2”.
4. Programme	- Programi për kthimin e 180.000 serbëve - Programi për kthimin e 250.000 serbëve (QKKM). - Programi stimulues për kthim të serbëve “2 lopë, 1 derr, 25 dele.”. Programi i Qeverisë së Kosovës për kthim.
5. Strategji	- Strategjia e BE-së për kthim (UNMIK, UNHCR, OSBE, KFOR). - Strategjia e Kushnerit - Strategjia e Hakerupit - Strategjia e Shtajnerit - Strategjia e Hollkerit - Strategjia e Qeverisë serbe.
6. Memorandume	- Memorandumi i mirëkuptimit - Memorandumi i kishës ortodokse serbe etj.
7. Marrëveshje	Marrëveshja Hakerup – Çović
8. Modele	“Tipi i fshatit Suedezë” për kthimin e serbëve në Kosovë.
9. Koncepte	Koncepti i UNMIK-ut për kthimin e serbëve në Kosovë.
10. Qendra koordinimi	Qendra koordinuese për kthimin e serbëve në Kosovë (drejtues Çović).
11. Rezoluta	Rezoluta XX / 2002 e Parlamentit të

	Kosovës për të drejtën e kthimit.
12. Standarde	Standardet e BE-së – UNMIK-ut “Standardet para statusit” njëri ndër 8 standardet është kthimi dhe riintegrimi i minoritarëve.
13. Zyra për kthime	Zyra e UNMIK-ut për kthime dhe bashkësi nëntor-dhjetor 2001.
14. Grupe pune	Grupe pune për kthime në 30 komuna dhe 5 rajone të Kosovës.
15. Vlerësime - Analiza	10 raporte analizash e vlerësimesh nga OSBE dhe UNHCR mbi kthimin dhe pozitën e minoritarëve në Kosovë.
16. Letër e hapur	Letër e hapur e liderëve kryesorë civilo-ushtarakë për kthimin e serbëve.
17. Kualicione	Kualicioni kthimi, Asociacioni i Kuvendeve Komunale për çështje të kthimeve.
18. Tryeza	- PER (Projekti për relacione etnike) Prishtinë, tetor 2001; Prishtinë, prill 2002; Lucern, nëntor 2003. - Tryeza të organizuara nga UNHCR, OSBE, dhe OJQ-të e tjera ndërkombëtare e vendore.
19. Debate	- Debate të organizuara nga institucione të Bashkësisë Ndërkombëtare në Kosovë. - Debate të organizuara në SM dhe në Kosovë nga institucione dhe OJQ.
20. Konferenca	Konferenca rajonale dhe vendore në Kosovë nga Bashkësia Ndërkombëtare, institucione dhe OJQ vendore.
21. Donatorë	3 Konferenca ndërkombëtare të donatorëve - ndihmat financiare për kthim nga zyrat e jashtme: SHBA 5.5 + 14 milion dollarë;

	Italia 3.5 milion euro, 2.5 milion euro Holkeri nga Italia; Gjermania 3.5 milion euro, Zvicra 1.1 milion euro; AER (Agjensia Europiane e Rindërtimit) 2 milion euro; UNHCR 6 milion euro; Finlanda 730 mijë euro; Nga suficiti i buxhetit të Kosovës 7 milion euro; etj.
22. Dokumente	• Akte, rekomandime, broshura, doracakë.
23. Viti i kthimit	• Viti 2003 është shpallur “Viti i kthimit”
24. Diskriminimi pozitiv	• Vendet e rezervuara për minoritarët e sidomos për ata serbë në Parlamentin e Kosovës etj.
25. Super diskriminimi pozitiv	• Koordinator Ndërmintor për kthimin e serbëve në Qeverinë e Kosovës dhe zyre për kthimin e serbëve pranë UNMIK-ut (Todoroviq, Radosavleviq).
26. Benefite	• 7 deri 24% e Buxhetit të Komunave të Kosovës dedikohet për minoritarët.
27. Inkurajime, avokitime, senzibilizime, kampanjë	• Pllakatat (poster, fletë-rrufe) • Kampanjë publike nëpër Ansambltë Komunale të Komunave të Kosovës për të inkurajuar dhe stimuluar kthimin. (Njëkohësisht janë paraparë edhe masa ndëshkuese për ata që pengojnë kthimin).
28. Decentralizimi	• Përveç tjerash është edhe në funksion të inkurajimit të kthimit të serbëve.
29. Katalogu i UNMIK-ut dhe KFOR-it për çështje të kthimit të serbëve	• “Doracak special metodologjik për kthim të qëndrueshëm”.
30. Masa speciale-optimale sigurie	• Serbët e kthyer janë në mbikëqyrje dhe mbrojtje speciale nga Batalioni i KFOR-it dhe policia ndërkombëtare.

31. Analiza dhe rekomandime nga organizatat ndërkombëtare	• ICG, Këshilli i Sigurimit i OKB-së, BE, Grupi i Kontaktit etj.
32. Parimet e programit të kthimit të brendshëm	• Metodë e punës nga lartë (Zyra e UNMIK-ut); Poshtë-Komunat.
33. Planet e Ansambleve Komunale për kthim dhe riintegrim të minoritarëve	• Në çdo komunë të Kosovës janë duke u hartuar e diskutuar plane për kthimin e minoritarëve.
34. Forume pune	• Forume pune janë grupe të veçanta punuese nga përfaqësues t UNMIK-ut, OSBE-së, UNHCR-së, KFOR-it dhe vendorë për të menaxhuar dhe monitoruar kthimin.
35. Grupe punuese regjionale për çështje të kthimit	• Ekziston ndarja në 5 rajone e grupeve të veçanta për të organizuar kthimin në shkallë të Kosovës.
36. “Bordi konsultues teknik”	• Janë grupe të veçanta për koordinimin e kthimeve.
37. Trupat mbi detyrat e kthimit	• “Organ mbikëqyrës heterogjen e i veçantë që përcjell kthimin e serbëve”
38. Asociacioni i Komunave serbe të veriut të Kosovës	• Strukturë paralele serbe me role dhe përgjegjësi të veçanta për organizimin e kthimit të serbëve në Kosovë.
39. SNV (Srbsko nacionalno veqe) – Këshilli Kombëtar serb	• Ka program të veçantë, e në koordinim me Beogradin për kthimin e serbëve në Kosovë dhe të Kosovës në Serbi.

Në ndërkohë ishin ndërrmarë një varg masash e aksionesh mobilizuese për të menagjuar dhe implementuar në praktikë këto politika të kthimit. Këtë e ilustron qartas pasqyra në vijim:

AKTORËT KRYESORË NË MENAXHIMIN E PROCESIT TË KTHIMIT TË MINORITARËVE NË KOSOVË

1. Zyra e UNMIK-ut për kthim dhe bashkësi	• Zyra qendrore në Prishtinë • 5 zyra rajonale • Zyra e stafit e vendosur në zyrën e UNMIK-ut në Beograd • Zyra për kthim dhe bashkësi
2. UNHCR	• Grupet punuese rajonale • Grupet komunale • Bashkëpunimi me OSBE-në lidhur me pozitën e pakicave • Koordinim me autoritetet dhe OJQ-të ndërkombëtare dhe vendore • Logjistika
3. UNHCR – Resposibilities (Serbi, Mali i Zi, Maqedoni)	• Bashkëpunim me UNHCR-in në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni
4. KFOR	• Vendosja dhe mirëmbajtja e ambientit të sigurtë në të cilën refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen në siguri (Rezoluta 1244, neni 9-c) • Ambient të sigurtë ofron policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i
5. Administrata Komunale e UNMIK-ut	• Planifikon dhe koordinon aktivitetet e kthimit në komunat e tyre • Grupet punuese komunale të administratës komunale dhe të administratës së UNMIK-ut • Mbikëqyrje e procesit të zhvillimit të koncept-dokumentit
6. Administrata Rajonale e UNMIK-ut	• Kryesues i administratës civile në rajon, Administratori Rajonal është kryesues i grupit punues rajonal dhe përgjegjës për mbikëqyrje zyrtare dhe

	koordinimin e grupeve punuese komunale
7. Njësitë rajonale të UNMIK-ut për kthim	• Bashkëveprim me UNHCR-in, KFOR-in dhe organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në çështjen e kthimit • Lehtësimin e kontakteve ndërmjet aktiviteteve rajonale të kthimit dhe bashkësive të zhvendosura, dhe kontributi në përpjekjet për informim publik, në bashkëveprim me personelin e UNMIK-ut/Beograd dhe personelin e zyrës për kthime dhe bashkësi (ZKB)
8. Zyra e UNMIK-ut për çështje të bashkësisë	• Nëpërmjet rrjetit të vetë të zyrave të bashkësive lokale në administratën lokale, Zyra për çështje të bashkësisë (ZÇB) koordinon çështjet vepruese mbrenda administratës qendrore dhe lokale me bashkësitë pakicë • Pjesëmarrja në grupin për koordinimin e kthimit • Përkrah integrimin e të kthyerve nëpër komuna
9. Shtylla e I-rë e UNMIK-ut	• Përfshinë policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në për mbajtjen e ambientit të sigurisë për personat e kthyer • Organet e drejtësisë (Departamenti i UNMIK-ut për drejtësi) • Drejtoria për çështje pronësore dhe banesore • Rregulloret e UNMIK-ut numër 1999/23 dhe numër 2000/60 krijojnë bazën për intervenimin e drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore në Kosovë
10. Shtylla e III-të e UNMIK-ut – OSBE-ja	• Ndërtimi i institucioneve • Vëzhgimi i mediave

	• Përkrahja e të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit • Përkrahja e përpjekjeve në fushën e kthimit
11. Shylla e IV-të e UNMIK-ut – Bashkësia Evropiane	• Përkrahja e aktiviteteve për t'i ngritur mundësitë ekonomike për pakicat dhe të ktyerit • Siguron trajtim të drejtë të bashkësive pakicë në administratë dhe shërbime publike
12. Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes	• Sigurimi për pakicat dhe të kthyerit qasje në shërbimet publike dhe sociale • Akordimi përkatës i resurseve buxhetore për kthim dhe integrim • Ngritja e pjesëmarrjes së pakicave në strukturat komunale dhe qeveritare
13. Donatorët	• Mbledhja e fondeve për procesin e kthimit nga bashkësia e donatorëve
14. Organizatat joqeveritare	• Planifikojnë, ndihmojnë dhe zbatojnë procesin e kthimit • Kontributi aktiv në hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve të kthimit në përputhje me kornizën për kthim të definuar nga çdo grup punues komunal
15. Qendra koordinuese për Kosovë dhe Metohi	• Institucion Qeveritar i ish-RFJ-së, tash SM koordinon mes autoriteteve të SM dhe UNMIK-ut për mbrojtjen e të zhvendosurve dhe kthimin e tyre në Kosovë, herë pas herë ndanë mjete financiare -donatorë në projektet e kthimit të serbëve në Kosovë
16. Shoqatat për personat e zhvendosur dhe refugjatë	• Ofrimi i informatave të sakta mbi kushtet e komuniteteve në Kosovë • Përfaqësimin e drejtë të interesave të komunitetit të tyre në diskutimet mbi kthimet

Ndërkohë pas ngjarjeve të marsit u "ngrinë" të gjitha projektet e më parshme të kthimit, dhe pa u bërë një analizë kritike shtruese për shkaqet e mos realizimit të atyre politikave dhe praktikave deri më atë ditë u nxorr plani i ri - draft (31.03.04) me titull "**Plani per implementimin e standardeve për Kosovën**". Ky plan parasheh një ndryshim rrënjesor, korrigjim radikal dhe parasheh forma të reja fundamentalisht tjera nga më të përparmet dhe lidhur me kthimin e të zhvendosurve kryesisht atyre serb (FQ 55 - 70) përmban 9 standarde , 53 detyra që duhet përkrahur nga 25 aktorë si shtylla e II, III, IV, UNHCR, AER, OHCR, IPVQ, PSSP, POLICIA, ZQB, ZQP, ZKB, DPI, GPK, ZQL, OJQ-të, njesitë rajonale për kthime, zyra këshilldhënëse, Kuvendi i Kosovës, ndërsa në të gjitha kuvendet komunale janë hapur vende të reja të punës për: Zyrtarë komunal për kthime. Natyrisht që ka edhe shumë organe tjera përgjegjëse



për implementimin dhe është caktuar dinamika - afati i përbushjes.

Sa më shumë që të njihet problemi i kthimit, sa më tepër që ta zbërthejmë në substancë problemin, fitohet përshtypja se të gjitha segmentet e proceseve zhvillimore politike, në njëfar mënyre preken, korrespondojnë ose përplasen në përpjestim të drejtë me këtë standard.

Në trinomin e kthimit janë të kyqur të gjithë aktorët e "krizës së kthimit": Ndërkombëtarët që pretendojnë që nëpërmes përbushjes së këtij standardi ta nxjerrin misionin e tyre rezultativ në Kosovë; Pala shqiptare sikur e sheh këtë standard si kusht drejt Pavarësisë dhe q'bllokimin e pengut në tregun financiar ndërkombëtarë, ndërkaq pala serbe "inkurajohet" për një kthim të qëndrueshëm substancial e dinjitoz në Kosovë (por edhe mbetjes për një kohë të Kosovës nën Serbi)!

Por në anën e padukshme të standardeve analistët serioz të zhvillimeve politike në Kosovë konstatojnë se ato mund të jenë tepër rrëshqitëse e veshtirë të realizueshme, sidomos pas kërkesave të fundme të palës serbe dhe Beogradit Zyrtëtarë.

Duke u nisur nga realiteti aktual politik dhe totaliteti i jetës në Kosovë kujtoj se plani i implementimit të standardeve për Kosovën, kështu çfare është projektuar, kthimi vështirë se mund të realizohet bile edhe po të ishte fjala për kthimin e rregullt të refugjatëve dhe migrantëve normal.

Përkundër të gjitha këtyre përpjekjeve, praktika provon për një kthim relativisht të paktë prej gjithsej 9100 vetësh në këtë periudhë. Shkaqet janë të ndryshme. Kujtoj se në rend të parë fakti

se pse ka një kthim të paktë qëndron fillimisht në instrumentalizimin që Beogradi i bën çështjes së kthimit. Si kundër-peshë kësaj i vihet padyshim edhe veprimtaria e herëpashërëshme e grupeve ekstremiste. Ndërsa një aspekt i rëndësishëm që shkakton hendikep në këtë çështje është paaftësia e ndërkombëtarëve për të kuptuar thelbin e natyrës së mospajtimeve dhe përplasjeve shqiptaro-serbe, rreth territorit dhe pamjes etnike të Kosovës.

Por me gjasë asgjë nuk ndikon më tepër në këtë drejtim sesa realitetet e reja që po krijohen dhe paqartësitë e të dyja palëve si të shqiptarëve shumicë poashtu edhe serbëve, rreth asaj se çfarë do të jetë e ardhmja e Kosovës.

Ramush Tahiri – Këshilltar Politik i Kuvendit të Kosovës

Me gjitha këto masa që u theksuan edhe sot nga profesori i nderur Rifat Blaku, ne mund të konstatojmë se rezultatet në procesin e kthimit të qytetarëve të shpërngulur të Kosovës nga Kosova janë katastrofale dhe nuk janë të kënaqëshme duke marrë parasysh edhe mundin edhe kohën. Demografët e dinë që qytetarët nëse nuk kthehen në periudhën e caktuar, pra nëse shkon një kohë e gjatë krijojnë kushte për të jetuar dhe për t'u risocializuar atje, e sidomos gjeneratat e reja që e kishin moshën madhore gjatë periudhës së shpërnguljes, dhe tash janë në moshën madhore dhe vullneti për t'u kthyer në segmentin psikologjik është shumë i vështirë dhe bindja për t'u kthyer në pronat në të cilat dikur ka jetuar familja e tij gati janë të pagjasa. Dhe në këtë bazë nëse realisht angazhohemi për një politikë të mirfilltë të kthimit për të



gjithë qytetarët, për një politikë të pa kushtëzuar, atëherë kushtëzimi do të ishte që mund t'i kemi afatet shumë konkrete për kthim dhe mund me pasë rezultate dhe për të mundur me përfunduar këtë proces ashtu si është me synimet mbarë Kosovare.

Ne themi që kthimi është individual, që kthimi është një e drejtë humane dhe se ky proces është proces human e jo politik. Por nëse i vërejmë të gjithë gërshetimet në situatën kosovare mund të konsiderohet se të gjitha segmentet kanë të bëjnë me një proces shumë të rëndësishëm politik. Nëse marrim edhe flasin për shkaqet e shpërnguljes nga Kosova duhet thjeshtësuar problemin se unë do të kisha thënë se shkaqet e njejta që i detyruan edhe shqiptarët një periudhë ma herët që të shpërngulen nga Kosova. Dikujt do t'i duket gjykim i rëndë por nëse flas për segmentin e një klimës së krijuar një dhunës psikologjike apo edhe një dhunës fizike, ani që ka dallim prej sistemit me plan gjenocidial të regjimit efektet e

.....por realisht vizioni i Kosovës vetëm për një popull do të ma kthente në një segregacion, do të na kthente në një rezervat edhe nuk do të ishte krijes e mirë për të hyrë në Evropë edhe faktikisht do të thonte një realizim i pak a shumë i politikës Millosheviqiane tash në anën shqiptare, dhe në këtë bazë koncepti për kthimin e secilit qytetar të shpërngulur nga Kosova në pronën e tij, në shtëpinë e tij, në punën e tij duhet të jetë një synim i të gjitha strukturave duke përfshirë edhe individët, por duke përfshirë edhe institucionet. Ky është koncept i asaj shoqërie që ne mendojmë në Kosovë me krijuar, pra nuk shoh koncept tjetër. Duke pasur edhe një përvojë në mjedis të kthimit, kam vërejtur që bëhet një gabim të themi i kushtëzuar, se bisedohet me individët për kushtet e kthimit. Shkohet në fshatin e caktuar pyeten banorët a do të pjtohen për kthim, edhe atyre ju thuhet gjithkujt pak a shumë që po ju them edhe unë që fati i Kosovës do të mvaret nga ky proces i kthimit të 30 familjeve, 40 familjeve krejt, dhe në këtë bazë përgjegjësia e individit i cili nuk është as me postë e as me angazhim, edhe ngarkohet edhe thuhet fjalë të mëdha edhe jep zakonishtë përgjegjje kur t'i pyesim fshatarët që nuk është e drejtë e tyre, edhe thojnë se nuk janë kriju kushtet me u kthye në fshatin

tonë, por le të shkojnë diku tjetër. Ende janë të freskëta pasojat e luftës, edhe thonë që Serbia duhet t'i krijojë disa kushte edhe faktikisht përzihet një program psikologjik, politik, ekonomik, e çfarëdo një propagandë, edhe ne kthehemi disi të turpëruar për atë arsye se nuk kemi arritë t'i bindmi fqinjët që t'i pranojnë rikthimin e fqinjëve të tyre. Ky kusht nuk ka qenë vetëm për shqiptarët, ky kusht nuk duhet të jetë as sot, edhe mua më duket një strategji e gabueshme për atë arsye se duhet secili institucion i nivelit më të ulët apo më të lartë duhet t'i kryej obligimet e veta. Edhe komunat t'i kryejnë obligimet e veta, edhe banorët t'i kryejnë obligimet e veta që të mos përzihet në jetën edhe pasurin e tjetrit dhe të krijohen kushtet e sigurisë dhe ekonomike për programin e kthimit të serbëve dhe malazezëve.

Mund të flas në kuadër të pasojave për disa qëllime. Qëllime të këqija nga njëra anë ose nga një anë tjetër. Ta marim për shembull qëllimi të ketë shqiptarë apo nationalist shqiptarë do të ishte që serbët të denohen për këtë çka ndodhi në Kosovë, dhe që t'ju mirret pasuria apo të bëjnë kushte që ata të mos mund të kthehen, (dhe në këtë bazë bëhen sandazhe të çfarëdo natyre), bëhen edhe presione, bëhen edhe grafite, bëhen edhe kërcënime gojore individuale, dhe në çfarëdo baze, a rezultati mund të jetë fare praktik që dikush don t'ia blen lirë pasurinë dikujt apo don t'ia uzurpojë dikujt pasurinë ose mund të themi se në këtë pikë takohen edhe të themi të këqijt shqiptarë edhe të këqijt serbë se që të dyve ju konvenon destabilizimi i Kosovës.

Vija serbe do të ishte në këtë bazë që të politizohen serbët dhe malazezët e shpërngulur, që të kushtëzohet kthimi i tyre me disa parakushte që duhet t'i plotësojnë organet e Kosovës dhe gjithashtu që të pengohet stabiliteti në Kosovë por ë pengohet edhe vendosja e statusit të Kosovës. Për atë arsye se nxiret numri që pa u kthyer të gjithë ata që dëshirojnë apo gjithë ata që janë shpërngulur nuk mund të bëhet as demokratizimi i Kosovës por

nuk mund të mirren as kompetencat që populli i Kosovës të vendosë për fatin e vet. Në këtë bazë ne gjindemi të dy pengë të njëri tjetrit, që të dy palët destabilizojnë rajonin, është fjala për segmentin negativ dhe që të dy e pengojnë njëri tjetrin që të hynë në Evropë. Kurse dihet se shtetet evropiane humbin një pjesë të sovranitetit por duke i marrë ato standarde më të larta që kanë të bëjnë me lirinë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në këtë bazë programet konkrete për kthim konsideroj se duhet të jenë në bazë të dëshirës vullnetare që secili individ të kthehet. Duhet t'i shohim favorët tona dhe ju e dini nga klima e krijuar sot, mundësi më të mëdha ka që të kthehen nëpër qytete për atë arsye se toleranca është më e madhe nëpër vendbanime ku është edhe lëvizja, qarkullimi i lirë gjithashtu është kthimi si masë më e lehtë. Edhe nëpër ato ku nuk ka pasur pasoja shumë të luftës për shembull ta zëmë regjoni i Gjilanit, Ferizajit apo mjediset që janë si të tilla dhe në këtë bazë duhet të ndërlihet angazhimi politik, duhet të ndërlihen donatorët me dëshirë dhe me programe konkrete të zhvillimit që nuk është një shpërblim për banorët e fshatit ku po kthehen por nëse ju siguron kushte për kthim, ju siguron shtëpi por nëse nuk ju siguron punë ai vetëm do ta shet shtëpinë dhe do të largohet. Por nëse ju siguron një kapacitet i cili lidhet me industrinë në çfarëdo pjese në cilindo fshat të Kosovës ku punojnë bashkarisht edhe shqiptarët edhe serbët atëherë ju krijon kushte edhe për bashkëjetsë por edhe ju krijon kushtet për me komuniku me njëri tjetrin edhe me u heq të gjitha këto që u folën për urrejtjen, mos durimin edhe të gjitha këto të tjerat. Vetëm si konstatim në kuadër të guximit tonë intelektual apo të themi institucional ende nuk kemi pasur guxim të shkojmë për të vizituar ndonjë kamp apo refugjatë që janë nëpër Serbi apo nëpër viset tjera. Ne duhet t'i konsiderojmë ata që janë qytetarë të Kosovës edhe kur kemi pranuar një detyrë duhet ta pranojmë edhe këtë që të shkojmë të bisedojmë edhe të ballafaqohemi edhe me rrezikun e

një konflikti verbal, shamje apo diçka për atë arsye se ky është një nga problemet më të vogla si delarative sa i përket prezentimit institucional të Kosovës.

Bajrush Berisha – Përfaqësues i kampit në Plemetin

Desha ta shfrytëzoj rastin t'i ceki disa probleme edhe mundësi do të thot si ide rreth rikthimit të disa kryefamiljarëve që ekzistojnë në komunën e Kastriotit të ish Obiliqit. Do ta ceki si shembull



konkret ku e cekën edhe më parë se në ato vendet enklave të cilat janë bërë kërkesa që të kthehen e pastaj do të bëhen sigurisht të mira jo rezultate por të dobëta, ndoshta është edhe ashtu por unë kam një mendim timin. Shembull konkret jam duke folur vetëm për rreth të Kosovës. Në kampin Plemetin ekzistojnë 148 kryefamiljarë, kurse individ janë reth 500 persona, ka edhe nga komuna të ndryshme duke filluar nga Lipjani, Skenderaj, Prishtina, kurse numri më i madh është nga komuna e Kastriotit. Nga komuna e Kastriotit në këtë vit janë kthyer 22 shtëpi në lagjen e Azotikut afër Çerkezëve, janë kthyer dhe tani janë të integruar duke filluar nga punësimi, kusre i kam 48 kryefamiljarë ku ata janë

pikërisht nga komuna e Obiliqit, 40 prej tyre kurrniherë nuk kanë pasur tokë, kanë jetuar gjithmonë në shtëpi private (me qera), ndërsa 8 prej tyre janë raste specifike për arsye se në rrugën Meto Bajraktari ka ekzistuar rruga ku kanë jetuar tri komunitete romë, ashkali dhe egjiptas. Pas luftës janë shitur ato shtëpi dhe ka mbetur vetëm një shtëpi. Kërkesat kanë qenë për shembull në lagjen e Azotikut ku janë ndërtuar 22 shtëpi a ekziston mundësia për një projekt që t'i bashkangjiten lagjes së Azotikut edhe disa shtëpi? Këtë e kam cekur edhe me një kërkesë dërguar Kuvendit të Kosovës që të rishqyrtohet dhe të hyn si rend dite. Poashtu është i njoftuar edhe kryeministri z.Bajram Rexhepi, ndoshta do t'i bie si lloj enklave, mirëpo nuk po kërkojmë një vend special me qenë por këto 8 raste t'u bashkangjiten kësaj lagje edhe komuna si komun kanë bërë përpjekje që të fillojmë rreth zhdukjes së kampit. Mirëpo, komuna thotë se komuna e Kastriotit nuk ka pronë, KEK-u ka më tepër tokë edhe duhet të bisedohet që t'u mundësohet këtyre 48 kryefamiljarëve apo t'i bashkangjiten asaj lagje.

Zef Shala – Përfaqësues i shoqatës Nëna Terezë

E falënderojmë organizatorin për një takim të tillë, por shpresoj që sikurse participantët tjerë të cilët nuk kanë ardhur në këtë moment ta dishin për një rëndësi të një teme të tillë gjegjësisht nga ekspozent që e



përgaditi profesori nderuar Rifat Blaku besoj që ndoshta pjesëmarrja do të ishte më e madhe, por pvarësisht prej kësaj të gjithë ne e dimë se Kosova momentalisht në pikëpamje politike administrohet nga administrata ndërkombëtare. Është UNMIK-u i cili përkujdeset për administrim të mirëfillt, është KFOR-i i cili kujdeset për sigurinë e qytetarëve, por janë edhe institucionet tona të cilat po bëjnë përpjekje permanente për një stabilizim të gjendjes të përgjithshme, duke përmendur edhe institucionet tjera siç janë TMK-ja, SHPK-ja etj. Unë do ta marrë këndshiqimin tim nga aspekti humanitar. Ju e dini fort mirë se në Kosovë mbi 12% e popullatës jetojnë në varfësi të skajshme, mbi 50% e popullatës jetojnë në varfëri dhe mbi 65% e popullatës është e pa inkuadrume, e pa punësuar fare. Kur këtij shenimi i bashkangjiten edhe problemet sociale të 180 mijë personave që marin ndihma sociale përmes qendrave për punë sociale, kur mbi 50 mijë të tjerë janë brengë e përditshme e humanitetit të organizatave joqeveritare duke iu bashkangjitur edhe shoqata Nëna Terezë. Janë mbi 100 mijë pensioner të cilët janë të pa kënaqur me ndihmat e tyre, kur

janë mbi 70 mijë persona të tjerë të moshës 55 deri 65 vjeçarë që nuk gëzojnë të drejta as të punësuar as të drejta të ndihmës sociale, andaj është shumë vështirë të mendohet për një kthim aq të shpejtë dhe të organizuar pa marrë parasysh të kujt. Ju e dini fort mirë se edhe shqiptarët edhe të gjithë të tjerët janë shpërngulur edhe për çashtje ekonomike dhe nuk kanë mundësi të kthehen. Problemet janë shumë të thjeshta, punësimi i tyre dhe mundësia e inkuadrimin në shoqëri në përgjithësi. Është shumë e qartë se siç po sihet nga bisedimet politike gjithmonë etnitetet serbe e kanë në gojë Kosova Metohija edhe kthimin e institucioneve të mëparëshme shtetërore. Kjo pyetje duhet definitivisht të hiqet nga koka e tyre, që në Kosovë jemi nën administrim ndërkombëtar, statusi i Kosovës ende nuk dihet, janë proceset në zhvillim e sipër, janë institucionet tona të cilat po bëjnë përpjekje për rregullimin e situatës politike, ekonomike etj. Por, a ka mundësi që të fillohet diçka? Ka mundësi. Ne si shoqatë humanitare Nëna Terezë të cilën e dini fort mirë kemi mbajtur një barrë 13 vjeqare në pikëpamje të ndryshme të humanitetit përmes projekteve të ndryshme zhvillimore ende kërkojmë që t'i japim ndihma vendeve ku janë të perziera, por me projekte me ndihma, nëse thuhet se duhet të kthehen serbët apo kroatët apo të tjerët me një fshat në Letnicë apo dikund tjetër, nëse nuk e krijojmë ndonjë vend të punës apo ndonjë ndihmë fillestare është shumë problematike të kthehesh. Një gjë e tillë vlenë edhe për bashkëvendësit e tyre. Nëse ju mundësohet serbëve që të kthehen edhe t'u japin programe të ndryshme atëherë kërkojnë edhe fqinjët e tyre. Çështjen e zhvillimit të infrastrukturës së përbashkët, nëse mendohet t'i shtrohet një rrugë me asfalt apo ndonjë kanalizim vetëm asaj familje e cila kthehet atëherë nuk është në rregull. Do të thotë duhet të mendohet për projekte të përbashkëta zhvillimore.

Ne kemi filluar edhe duhet të insistohet që përmes dialogut civil sepse dialogu civil është për momentin forma më e pëlqyer e

një hapi të mëtutjeshëm drejt një dialogu politik. Këtë po e përmendi me një qëllim të caktuar se e dinë zotërinjtë nga UNHCR-ja dhe nga OSCE-ja se këto janë për demokratizim të shoqërisë civile se është viti i dytë kur ne si shoqatë Nëna Terezë që e përfaqësojmë Kosovën dhe qendra për regjionalizim nga Novi Sadi ka realizu 5 projekte të dialogut civil, pa përzierje të punëve të brendëshme politike. Kontaktet e OJQ-ve të grave dyanësore, OJQ-të rinore dhe bashkëpunimi regjional sidomos të mediave ka dhënë hapa të parë të një bashkëpunimi civil, kur priten këtë vit veç të realizohen disa projekte të vogla është sukses nëse ne arrijmë që t'i ulim në tavolinën e përbashkët OJQ-të vendore tonat të minoriteteve dhe të grupeve të tjera etnike me OJQ-të të cilat vijnë nga Serbia, nga Mali i Zi etj. Të bisedohet për mundësitë reale se është shumë e vërtetë nëse mendojmë t'i kthejmë njerëzit me dhunë e mos t'ju sigurojmë kushte për punë gjegjesisht kushte për një jetesë të përbashkët atëherë projekti veç është i dështuar. Andaj shfrytëzoj rastin që edhe kësaj radhe edhe organizatorit edhe të gjitha institucioneve tona të Kosovës dhe përfaqësuesve ndërkombëtar që ne si shoqatë Nëna Terezë besoj që do të hasim në përkrahje edhe te të gjithë të tjerët që përmes formave të dialogut civil të fillojmë që vërtetë të shihen rezultatet e para të një riatdhesimi dhe rikthimi. Por para se të kthehen përmes dialogut civil të zgjidhen problemet paraprake, të bisedohet ashtu siç përmendi edhe këshilltari i Kuvendit të Kosovës, të bisedohet për problemet të cilat kanë qenë dhe ata që i mundojnë tani. Shpresoj se ky takim është një takim fillestar i mirë por mos të ndalemi me kaq dhe llogaritni që edhe ne si shoqatë Nëna Terezë përmes projekteve tona që veç i kemi të reklamuar të gjejmë përkrahje edhe nga donatorët por edhe nga institucionet tona si të Kosovës edhe ato ndërkombëtare.

Kryeadministratori i Kosovës vizitoi refugjatët serbë dhe romë në Smederevë

Steineri: “UNMIK-u tashmë po ndërmerr hapa konkretë për kthimin e serbëve”

Kryeadministratori i Kosovës, Michael Steiner, pasi vizitoi rreth 700 romë dhe serbë në qendrën për të zhvendosur dhe refugjatë, në afërsi të Smederevës, deklaroi, në një konferencë për gazetarë në Beograd, se, UNMIK-u është duke ndërmarrë hapa konkretë për kthimin e serbëve të zhvendosur në Kosovë.

Michael Steineri njoftoi se UNMIK-u ka marrë 3,5 milionë euro nga Qeveria e Italisë për financimin e një projekti të madh për kthimin e serbëve në rajonin e Pejës dhe rreth 1 milion euro të tjera nga Qeveria Gjermane për rajonin e Klinës.

Steineri poashtu njoftoi se në Kosovë janë themeluar 24 grupe punuese komunale për çështjen e kthimit të serbëve.

“Në Kosovë mirëbesimi po rritet, nuk është i mjaftueshëm por është më i mirë se sa që mendojnë shumë njerëz këtu”, tha ai, duke shtuar: “Mund të shihni në Prishtinë automjete me targa serbe dhe poashtu mund të degjohet edhe gjuha serbe”.

Steineri, i cili ishte i shoqëruar nga Nenad Radosavleviq, këshilltar për kthimin e serbëve në zyrën e kryeadministratorit, i njoftoi gazetarët serbë se Qeveria e Kosovës po angazhohet aktivisht në çështjen e kthimit të serbëve.

Ai përkujtoi se Kuvendi i Kosovës në seancën e së enjtes miratoi Rezolutën mbi të drejtën e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre mbi kushtet e kthimit të të zhvendosurve dhe refugjatëve.

“Shumica e qytetarëve të Kosovës, që jetojnë në liri, duhet të japin kontribut aktiv drejt krijimit të kushteve të njëjta për ata që nuk kanë mundësi të shfrytëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të lirë dhe të plotë, duke përfshirë edhe të drejtën për t’u kthyer në shtëpitë e tyre”, e citoi Steineri paragrafin e pestë të rezolutës së miratuar të enjëten nga Kuvendi i Kosovës.

I pyetur nga një gazetarë pse ai nuk e përdor termin “Kosovë dhe Metohi” si dhe pse e lejoi “skandalin” rreth këtij nocioni në seancën e së enjëtes, Steineri u përgjigj se ai mbështetet në dokumentin fundamental – Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, ku territori që ai administron quhet Kosovë.

“Por unë nuk ua mohoj juve që kur më flisni të thoni “Kosovo i Metohija”, ashtu siç nuk ua mohoj shqiptarëve që të më thonë Kosova. Por mos më kritikoni kur e përdori shprehjen Kosovo, ashtu siç është në rezolutë”, tha ai.

Steineri sqaroi edhe një çështje tjetër të ngritur nga mediumet dhe Qeveria serbe se do të bisedohet për borgjet që Serbia pohon se Kosova duhet t’ia paguajë. Mirëpo, ai theksoi se Kosova nuk i ka borgj asnjë institucioni ndërkombëtar sepse nuk është shtet i pavarur.

“Kosova si Kosovë nuk i ka borgj askujt në botë, sepse nuk është e aftë për atë punë, sepse nuk është shtet”, tha ai.

Steineri do të vazhdojë vizitën në Beograd edhe nesër, kur është paralajmëruar takimi me zyrtarin serb të ngarkuar me çështjet e Kosovës, Nebojsa Çović¹.

¹ KOHA Ditore, e shtunë 6 korrik 2002

Soren Jessen-Petersen, kryesues i Komitetit për Çështje të Kthimeve dhe Azilit në Paktin e Stabilitetit

Në Kosovë, me gjithë punën që është bërë për kthimet, rezultatet janë të kufizuara

Me gjithë punën që është bërë në terren për krijimin e kushteve për ata që dëshirojnë të kthehen, rezultatet janë të kufizuara, ka vlerësuar të premten në Prishtinë Soren Jessen-Petersen, kryesues i Komitetit për Çështje të Kthimeve dhe Azilit në Paktin e Stabilitetit. UNMIK-u dhe Qeveria e Kosovës, sipas tij, janë duke bërë përpjekje për të krijuar kushte për të zhvendosurit, në mënyrë që ata më pas vetë të përcaktohet nëse dëshirojnë të kthehen apo të qëndrojnë aty ku janë.

Zyrtari i lartë i Paktit të Stabilitetit ka thënë se politizimi i çështjes së kthimeve asnjëherë nuk ka qenë i dobishëm. “Mendoj se është jashtëzakonisht me rëndësi që çdo politikan, kudo që të jetë ai, të mos e përdorë kthimin e refugjatëve në një lojë politike, apo për të marrë poena në politikë. Unë nuk dua të bëj asnjë koment se një person e bën këtë, apo e bën atë, por e tëra që mund të them është se politizimi i kësaj çështjeje nuk është i dobishëm”, ka thënë Soren Jessen-Petersen.

Kosova ka qenë stacioni i fundit rajonal i delegacionit të Komitetit për Çështje të Kthimeve dhe Azilit në Paktin e Stabilitetit. Ata që nga e hëna kanë filluar turneun e vizitave në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke vizituar Zagrebin, Sarajevën, Beogradin dhe Prishtinën. Të enj ten ata në Prishtinë janë takuar me

kryeministrin e Kosovës, Bajram Rexhepi, zyrtarë të UNMIK-ut, të UNHCR-së dhe të OSBE-së.

